

FTESË PËR OFERTË

Objekti: Ekspert për studim

Autoriteti kontraktues: Shoqata MEDPAK

Informacion i përgjithshëm

Shoqata MEDPAK në partneritet me bashkinë Prrenjas ” në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD, projekt i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga UNDP. Fokusi i këtij projekti është: “Shërbime për Fëmijët me aftësi të kufizuara”.

Në këtë projekt gjashtëmujor ne do të punojmë për grupin Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara në disa drejtime:

- a) Të vlerësojmë nevojat e cdo Fëmije me Aftësi të Kufizuara (FAK) dhe të hidhen ato në një database të ndërtuar për këtë qëllim
- b) Të japim shërbime të fizioterapisë dhe logopedisë për fëmijët me AK në një qendër ditore të cilën bashkia e vë në dispozicion për këtë qëllim.
- c) Të ndërgjegjësojmë prindërit, mësuesit dhe institucionet për të drejtat e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara nëpërmjet takimeve të hapura, bisedave në grup dhe trajnimeve.

Ky projekt do të shërbejë bashkisë si model i ndërtimit të një Qendre Sociale për njerëzit me aftësi të kufizuara që bashkia e ka në planet e veta për të ardhmen.

Për vlerësimin e nevojave të cdo FAK do të organizohet një intervistë në familje , do të plotësohet një fletë vlerësimi dhe do të ndërtohet nja data base ku do të hidhen gjithë të dhënat e dala nga intervista.

Detyrat e ekspertit

Eksperti duhet të analizojë të dhënat e 200 Fletëve të Vlerësimit (Një kopje e kësaj flete gjendet bashkangjitur). Fletët e vlerësimit janë plotësuar me specialistë nga intervista që do të bëhet në familje me prindërit ose kujdestarët si dhe duke vëzhguar fëmijën me aftësi të kufizuara. Këta specialistë janë trajnuar për vlerësimin e nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Më specifikisht, duhet krijuar database me të gjitha përgjigjet e fletës së vlerësimit dhe do të hidhen të gjitha të dhënat e dala nga vlerësimi në database.

Database do të dorëzohet edhe zyrës së shërbimeve në bashkinë Prrenjas, me qëllim vlerësimin e nevojave edhe të PAK të tjerë ose fëmijëve që do të shtohen listës së fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Kualifikimet e kërkuara

1. Të ketë mbaruar studimet në fakultetin e shkencave kompjuterike
2. Eksperiencë pune të ngjashme
3. Preferohet të ketë njohuri në fushën e aftësisë së kufizuar
4. Preferohet të jetë banor në Bashkinë Prrenjas

Dokumentacioni i detyrueshëm

- ❖ CV e detajuar
- ❖ Kopje e diplomës
- ❖ Letërmotivimi

Subjektet e interesuar duhet të dërgojnë dokumentacionin në adresën:

Rr. Qazim Murtini, Ndërtesa nr 13 ,Lagja nr 2, ose me e-mail në adresën info@medpak.org, deri në datën 22 Nëntor 2019

Kriteret e vlerësimit

Vlerësimi i ofertave do të mbështetet duke pasur si reference kualifikimet e kërkuara më sipër.

Njoftimi i fituesit

Fituesi do të njoftohet me e-mail brënda datës 29.11.2019